

## Raport për rezultatet e konsultimeve publike

### 1. Titulli i draftaktit

Projektligjin “Për shndërrimin, bashkimin dhe ndarjen ndërkufitare të shoqërive tregtare”

### 2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike: 20 ditë Pune, 11.08.2025 - 08.09.2025, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

### 3. Metoda e konsultimit

Projektligji synon përafrimin me Direktiven 2017/1132/KE dhe ruajtjen e koherencës me legjislacionin ekzistues.

Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” për periudhën 11.08.2025 - 08.09.2025. Përmes publikimit në RENJK, në zbatim të ligjit 146/2014, janë ftuar qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik.

Projektligji, relacioni shpjegues, RIA dhe Tabela e Përputhshmërisë, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente.

### 4. Palët e interesit të përfshira

974 vizitorë kanë lexuar projektligjin nëpërmjet RENJKP. Palët e interesit janë qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut.

**1 palë interesi ka dërguar koment lidhur me projektligjin e publikuar.**

### 5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

<b>Çështja e adresuar</b> (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	<b>Komenti</b> (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	<b>Palët e interesuara</b> (renditni të gjithë ata që adresua)	<b>Vendimi</b> (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	<b>Justifikimi</b>
---	--	---	---	--------------------

		<i>n çështjen në mënyrë të ngjashm e)</i>		
Qartësimi i përkufizimit të "shoqërisë evropiane" dhe përcaktimi i subjekteve të vendeve të ZEE-së që përfshihen në fushën e zbatimit të projektligjit.	Përkufizimi i "Shoqëri evropiane" (Neni 3, pika 9): Në projektligj përcaktohen "shoqëritë evropiane" si shoqëri të regjistruar në një vend që është palë në traktatet e BE-së dhe ZEE-së, kështu gjykoj se mund të qartësohet shprehimisht në aktet nënligjore nëse kjo përfshin edhe shoqëri nga vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE) si Norvegjia, Islanda, Lihtenshtejni dhe Zvicra, duke marrë parasysh marrëdhëniet e tyre të ngushta ekonomike me BE-në. Kjo do të parandalonte paqartësitë në zbatim.	Av. Endrit KAPAJ	I refuzuar	Bazuar në Direktivën (BE) 2017/1132 të përditësuar, neni 86b (për shndërrimet), neni 119 (për bashkimet) dhe neni 160b (për ndarjet) përcaktojnë se këto procedura zbatohen për shoqëritë e formuara në përputhje me ligjin e një shteti anëtar dhe që kanë selinë apo qendrën kryesore të veprimtarisë brenda Bashkimit Evropian. Sqarojmë se përkufizimi i "shoqërisë evropiane" në projektligj përfshin automatikisht

				<p>t shtetet e Norvegjisë, Islandës dhe Lihtenshtejn it, pasi sipas Protokollit 1 të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE), çdo referencë ndaj "Shteteve Anëtare" në direktivat e BE-së interpretohet si përfshirje edhe e shteteve të EFTA-s që janë pjesë e ZEE-së.</p> <p>Referenca në anglisht: 9. REFERENC ES TO NATIONAL S OF EC MEMBER STATES Whenever the acts referred to contain references to nationals of EC Member States, the references shall for the purposes of the Agreement</p>
--	--	--	--	---

				be understood to be references also to nationals of EFTA States.
<p>Detajimi i procedurave dhe kriterëve për krijimin dhe funksionimin e organit të posaçëm negociues për përfaqësimin e punëmarrësve.</p>	<p>Specifika e organit të posaçëm negociues për përfaqësimin e punëmarrësve (Neni 7, pika 5 e vijues): Projektligji parashikon krijimin e një organi të posaçëm negociues për punëmarrësit, ku ndonëse kërkesa është e qartë, aktet nënligjore mund të detajojnë më tej kriteret shteruese se kur kërkohet një organ i tillë, sikurse procedurat e hollësishme për përzgjedhjen ose njohjen e përfaqësuesve të punëmarrësve (veçanërisht në shoqëritë pa sindikata të themeluara), dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve potenciale lidhur me përfaqësimin ose votimin e punëmarrësve.</p>	<p>Av. Endrit KAPAJ</p>	<p>I refuzuar</p>	<p>Sqarojmë se neni 7 i projektligjit është konceptuar si një dispozitë e zbatueshme dhe nuk paraqet nevojë për rregullim të mëtejshëm me akte nënligjore. Ky nen transponon në mënyrë te plote kërkesat e Direktivës (BE) 2017/1132, duke përcaktuar në pikën 6 afatet , formatin elektronik të njoftimit dhe subjektet përfituese, ndërkohë që për çdo aspekt procedural të përfaqësimit</p>

				apo zgjidhjes së mosmarrëve shjeve, pika 10 e këtij neni bën referencë te Kodi i Punës .
Përcaktimi i standardeve dhe kritereve për raportin e ekspertit të pavarur lidhur me vlerësimin e kompensimit monetar dhe raportit të këmbimit të aksioneve.	Raporti i ekspertit të pavarur (neni 8): Projektligji kërkon raporte të pavarura nga ekspertë të licencuar për të vlerësuar përshtatshmërinë e kompensimit në mjete monetare dhe raportin e këmbimit të aksioneve. Për të siguruar një vlerësim të drejtë, aktet nënligjore duhet të ofrojnë udhëzime më të detajuara mbi: (i) Metodologjitë specifike të vlerësimit dhe standardet që duhet të përdoren nga ekspertët. (ii) Fushën dhe ekspertizën e shqyrtimit të ekspertit, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e ndikimit tek punëmarrësit dhe masat për kreditorët. (iii) Kriteret e kualifikimit dhe pavarësisë për këta ekspertë, përtej kërkesave të përgjithshme të licencimit.	Av. Endrit KAPAJ	I refuzuar	Në lidhje me sugjerimet për detajimin e raportit të ekspertit të pavarur, sqarojmë se projektligji nuk paraqet nevojë për akte të reja nënligjore,se pse ekspertët veprojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, të cilat janë pjese e legjislacionit shqiptar. Neni 8 i projektligjit parafron ne menyre te plote nenin Neni 86f Raporti i ekspertit të pavarur te Direktivës (BE) 2017/1132, ku roli i

				ekspertit është fokusuar për vlerësimin e kompensimit në mjete monetare.
Forcimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e procedurave ndërkufitare.	Forcimi i koordinimit ndërinstitucional: Projektligji thekson nevojën për koordinim ndërmjet QKB-së, autoriteteve tatimore, doganore, të sigurimeve shoqërore, të punës, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Konkurrencës. Për të garantuar një zbatim efikas, mund të sugjerohet krijimi i protokolleve formale të bashkëpunimit, grupeve të punës ndërinstitucionale ose memorandumeve të mirëkuptimit. Këto mekanizma do të siguronin një rrjedhë informacioni pa probleme, zgjidhje të përbashkët të problemeve, veçanërisht për rastet komplekse që përfshijnë shumë organe rregullatore.	Av. Endrit KAPAJ	I refuzuar	Lidhur me sugjerimin për forcimin e koordinimit ndërinstitucional, sqarojmë se projektligji ka parashikuar mekanizma efikasë që shmangin nevojën për protokolle apo grupe pune manuale, duke u mbështetur në Sistemin e Ndërlidhjes së Regjistrave Tregtarë (BRIS). Ky sistem, i krijuar në zbatim të Direktivës (BE) 2017/1132, mundëson shkëmbimin automatik dhe në kohë

				reale të informacionit midis QKB-së dhe regjistrave të vendeve anëtare.
Qartësimi i mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe përcaktimi i afateve procedurale për shqyrtimin gjyqësor.	Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe afatet kohore: Në projektligj parashikohet e drejta e aksionarëve dhe kreditorëve për t'iu drejtuar gjykatës, megjithatë mund të përcaktohen afate kohore më specifike për proceset e shqyrtimit gjyqësor, veçanërisht për çështje kritike si pezullimi i një shndërrimi apo ndarjeje. Neni 53.4 dhe 53.5 parashikon një afat 30-ditor për zgjidhjen e kërkesave për kompensim shtesë nga aksionarët në ndarje, gjë që është pozitive, megjithatë, një qartësi e ngjashme për mosmarrëveshje të tjera do të rriste efikasitetin dhe sigurinë juridike	Av. Endrit KAPAJ	I refuzuar	Lidhur me afatet gjyqësore, sqarojmë se projektligji nuk ka nevojë për rregullime shtesë pasi afatet 30 dite janë vendosur vetëm për çështjet financiare që të mos bllokohet biznesi, ndërsa për çdo padi tjetër zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Përcaktimi i afateve të reja për çdo lloj debati do të ndërhynte në punën e gjykatave dhe do të krijonte konfuzion. Për mosmarrëve

				shje të tjera të natyrës civile apo tregtare, vlerësohet se kodi i procedurës civile ofron garancitë e nevojshme.
--	--	--	--	---